



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

---

Numri i lëndës: 2023:215605

Datë: 28.05.2024

Numri i dokumentit: 05742080

P.nr.2023:215605

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Samedin Cena, me zyrtarin ligjor Fatlind Kryeziu, në çështjen penale kundër të akuzuarit V.H., nga Peja për shkak të veprës penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185, par.1, nënpar.1.4 të KPRK dhe të akuzuarit A.V., nga Gjakova për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 184, par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, të akuzuar nga Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm sipas Aktakuzës me numër PP/II.nr.1626/22 të datës 11.10.2023, në bazë të nenit 357 par.1 nën par.1.3 të KPPRK-së si dhe nenit 11 dhe 15 të Ligjit nr.06/L-009 për Ndërmjetësim, jashtë seance me datë 28.05.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET Marrëveshja për ndërmjetësim me numër Nd.nr.42/24 e datës 23.05.2024 e lidhur në mes të akuzuarit – dëmtuarit V.H., nga Peja dhe të akuzuarit – dëmtuarit A.V., nga Gjakova.
- II. HUDHET Aktakuza e Prokurorisë Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.1626/23 e datës 11.10.2023 dhe PUSHOHET procedura penale ndaj të akuzuarit V.H., nga Peja për shkak të veprës penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185, par.1, nënpar.1.4 të KPRK – së dhe të akuzuarit A.V., nga Gjakova për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 184, par.2 lidhur me par.1 të KPRK – së për shkak se palët kanë arritur marrëveshje në procedurën e ndërmjetësimit.

III. Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur Aktakuzën PP/II.nr.1626/23 të datës 11.10.2023 kundër të akuzuarit V.H., nga Peja për shkak të veprës penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185, par.1, nënpar.1.4 të KPRK dhe të akuzuarit A.V., nga Gjakova për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 184, par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Gjykata Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm më datën 14.05.2024, ka mbajtur shqyrtimin fillestar në këtë çështje penale në të cilin shqyrtim ishin prezent Prokurori i shtetit Shqiponja Jupa, i akuzuari – dëmtuari V.H., me mbrojtësen e tij avokate Aurora Mulhaxha nga Peja dhe i akuzuari – dëmtuari A.V.,

E autorizuar e të akuzuarit V.H., avokate Aurora Mulhaxha deklaroi se pasi që vepra për të cilën akuzohet i mbrojturi im është e përshtatshme për ndërmjetësim i propozoj gjykatës që kjo lëndë të dërgohet në procedurën ndërmjetësimi.

I akuzuari – dëmtuari A.V., pajtohet me propozimin që lënda të dërgohet në procedurën e ndërmjetësimi.

Prokurori i shtetit Shqiponja Jupa deklaroi se nuk e kundërshtojmë propozimin e avokates që kjo lëndë të referohet në ndërmjetësim pasi që plotësohen kushtet nga neni 229 i KPPRK – së.

Gjykata pasi mori mendimin e Prokurorit të shtetit Shqiponja Jupa dhe akuzuarit – dëmtuarit A.V., aprovoi propozimin e mbrojtëses së të akuzuarit V.H., avokate Aurora Mulhaxha që kjo çështje juridiko penale të dërgohet në organin e ndërmjetësimi dhe është ndërprerë shqyrtimi, ndërsa janë udhëzuar palët që këtë çështje ta zgjidhin në procedurën e ndërmjetësimi.

Me datën 23.05.2024, në Gjykatën Themelore në Gjakovë, në prezencën e ndërmjetësuesit Mark Kaçinari, është lidhur marrëveshja për zgjidhjen e ndërmjetësuar ndërmjet të akuzuarit – dëmtuarit V.H., nga Peja, pëafqësuar nga mbrojtësja e tij avokate Aurora Mulhaxha nga Peja

dhe të akuzuarit – dëmtuarit A.V., nga Gjakova, përfaqësuar nga mbrojtësi i tij, avokat Shaqir Zika nga Rahoveci.

Ndërmjetësuesi Mark Kaçinari me vendimin Nd.nr.40/24 të datës 14.05.2024 ka pranuar marrëveshjen e palëve për zgjidhje të ndërmjetësuar.

I akuzuari – dëmtuari V.H., dhe i akuzuari – dëmtuarit A.V., i kanë shprehur keqardhje dhe i kërkojnë falje njëri tjetrit për ngjarjen, njëherit deklarohen se tërhiqen nga çdo lloj kërkesë dhe kompensimi financiar dhe jofinanciar si dhe tërhiqen nga çdo lloj kërkesë tjetër përkitazi me rastin në fjalë dhe kjo çështje trajtohet si e përfunduar – e mbyllur.

Andaj, gjykata duke vepruar konform dispozitave të nenit 15 të Ligjit për ndërmjetësim e aprovoi këtë marrëveshje pasi që të njëjtën e vlerësoi se është lidhur me vullnetin e plotë të palëve në konflikt dhe në pajtim me ligjin në fuqi. Konform nenit 15 të Ligjit për Ndërmjetësimin me datën e pranimit nga gjykata përkatësisht nga data 28.05.2024, e njëjta do ta ketë fuqinë e titullit ekzekutiv.

Gjykata duke u bazuar në provat si më lartë dhe në bazë të nenin 357 par.1 nënpar.1.3 të KPPRK-së dhe nenit 11 dhe 15 të Ligjit nr.06/L-009 për Ndërmjetësim vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.2023:215605, me datë 28.05.2024

Zyrtari ligjor  
Fatlind Kryeziu

Gjyqtari  
Samedin Cena

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 3 ditësh nga dita e marrjes Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmes të kësaj gjykate.